

LIGJ

Nr.10 093, datë 9.3.2009

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E  
SHOQËRISË CIVILE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është organizimi dhe funksionimi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në vijim AMSHC dhe përcaktimi i procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile.

Neni 2

Statuti, selia dhe personaliteti juridik

1. AMSHC-ja është ent publik qendror, buxhetor dhe vepron për përmbushjen e misionit dhe të objektivave të saj, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi.
2. Organet e AMSHC-së e ushtrojnë veprimtarinë në mbështetje të ligjit dhe të statutit.
3. Vendimet e AMSHC-së duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin në fuqi dhe me statutin e saj.
4. Statuti i AMSHC-së miratohet nga Këshilli i Ministrave.
5. Selia e AMSHC-së ndodhet në Tiranë. Këshilli i Ministrave vë në dispozicion të kësaj agjencie mjedise të përshtatshme për funksionimin dhe kryerjen e veprimtarisë normale të saj, sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 3

#### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoriteti financues” është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe/ose çdo autoritet publik, qendror apo vendor, që shpërndan fonde nga buxheti i vet, për mbështetjen e shoqërisë civile.
2. “Kandidat” është çdo subjekt përfitues, që merr pjesë në një procedurë konkurrimi, sipas këtij ligji.
3. “Granti” është shuma e përcaktuar e fondit për mbështetjen e shoqërisë civile, e shpallur në dokumentet e konkurrimit, gjatë një procedure konkrete, që i dhurohet pa interes subjektivit përfitues nga autoriteti financues, në përputhje me kriteret e vendosura sipas këtij ligji.
4. “Dokumentet e konkurrimit” janë dokumentet, që autoriteti financues ua vë në dispozicion të gjithë kandidatëve të interesuar për përgatitjen e projektpropozimeve.
5. “Shpenzime të pranueshme” janë shpenzimet, që merren parasysh për një fond, për mbështetjen e shoqërisë civile.

6. “Veprimtari në të mirë e në interes të publikut” është çdo veprimtari, që ka si qëllim bazë realizimin e një interesi publik.

## KREU II

### MISIONI DHE OBJEKTIVAT E AMSHC-SË

#### Neni 4

##### Misioni dhe objektivat

1. AMSHC-ja ka mision themelor nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.
2. Për realizimin e misionit, AMSHC-ja ofron asistencë financiare për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera, që lehtësojë përmbushjen e misionit të saj.
3. Në ushtrimin e veprimtarisë, AMSHC-ja udhëhiqet nga përparësitë strategjike të qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile.
4. Dispozitat e mësipërme janë të zbatueshme për çdo autoritet tjetër financues, sipas këtij ligji.

## KREU III

### KANDIDATËT PËRFITUES DHE PARIMET E PËRZGJEDHJES

#### Neni 5

##### Kandidatët përfitues

AMSHC-ja dhe çdo autoritet tjetër financues mbështesin e asistojnë, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe në përputhje me përparësitë strategjike, nisma, programe e veprimtari me karakter jofitimprurës:

- a) të organizatave të shoqërisë civile, të cilat janë të regjistruara sipas ligjit, ushtrojnë veprimtari sipas objektit të përcaktuar në statutin e tyre dhe janë aktive gjatë vitit fiskal në vijim, me përjashtim të partive politike, sindikatave, institucioneve fetare dhe organizatave politike, që përfitojnë fonde publike;
- b) të personave fizikë për mbështetje në kërkime dhe studime, pjesëmarrje në veprimtari publike ndërkombëtare dhe lloje të tjera mbështetjeje individuale, sipas programeve specifike të agjencisë.

## Neni 6

### Parimet e përzgjedhjes

Në procesin e shqyrtimit e të përzgjedhjes së kandidatëve përfitues dhe të shpërndarjes së fondeve për mbështetje të shoqërisë civile, sipas këtij ligji, çdo autoritet financues mbështetet në parimet e mëposhtme:

- a) lirinë e pjesëmarrjes dhe të konkurrimit;
- b) mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë;
- c) transparencën e procedurave e të vendimmarrjes, duke u ofruar të gjithë kandidatëve të dhënat dhe procedurën përkatëse;
- ç) përputhshmërinë me objektivat e grantit dhe me efektivitetin e përdorimit të burimeve, në bazë të sistemit të konkurrimit dhe kriterëve, që mundësojnë vlerësimin e projektpropozimit dhe specifikimeve teknike e financiare për përzgjedhjen e shpërndarjen e grantit;
- d) mungesën e prapaveprimit, duke përjashtuar mundësinë e shpërndarjes së fondeve për veprimtari tashmë të realizuara në datën e vendimmarrjes;
- dh) paanshmërinë e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe parandalimin e konfliktit të interesave;
- e) përjashtimin e mbivendosjes, që nënkupton shmangien e financimit të së njëjtës veprimtari për të njëjtin interes konkret, më shumë se një herë, gjatë një viti fiskal.

## KREU IV

### ORGANET E AMSHC-SË

#### Neni 7

##### Organet e AMSHC-së

1. Organet e AMSHC-së janë bordi mbikëqyrës dhe drejtori ekzekutiv.
2. Statuti i AMSHC-së mund të përcaktojë organe të tjera ekzekutive, këshillimore ose ndihmëse.
3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve të AMSHC-së përcaktohen në statut dhe në vendimet e bordit mbikëqyrës.
4. Anëtarët e organeve të AMSHC-së i kryejnë funksionet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të legjislationit në fuqi, statutit dhe akteve të tjera të përgjithshme të AMSHC-së.

#### Neni 8

##### Përbërja dhe emërimi i bordit mbikëqyrës

1. AMSHC-ja drejtohet nga bordi mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 9 anëtarë.
2. Bordi mbikëqyrës i AMSHC-së përbëhet nga 5 anëtarë, që përfaqësojnë organizatat e shoqërisë civile dhe 4 anëtarë, që përfaqësojnë institucionet e administratës publike qendrore.
3. Këshilli i Ministrave, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, i emëron 4 anëtarët e bordit mbikëqyrës nga përfaqësues të institucioneve të administratës publike qendrore dhe 5 anëtarët nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, sipas parimit të përfaqësimit të barabartë gjinor.
4. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të përmendur në pikën 3 të këtij neni, emërohen në bazë të përvojës e të kontributit, sipas përfaqësimit të fushave kryesore e parësore të zhvillimit dhe përparësive strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile. Organizatat e shoqërisë civile, të regjistruara sipas ligjit, kanë të drejtë t'i dërgojnë propozimet për përfaqësim në bordin mbikëqyrës, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

5. Procedurat dhe rregullat, në përputhje me përcaktimet e këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 9

Detyrat e kompetencat e bordit mbikëqyrës

Bordi mbikëqyrës ka këto detyra e kompetenca:

- a) harton statutin e AMSHC-së;
- b) miraton rregullat e hollësishme për kushtet dhe procedurat për shpërndarjen e fondeve, në përmbushje të misionit të AMSHC-së;
- c) shqyrton raportet e veprimtarisë së AMSHC-së dhe miraton planin e veprimeve, sipas fushave;
- ç) miraton buxhetin vjetor të AMSHC-së;
- d) miraton raportet financiare;
- dh) miraton rregullat e funksionimit të personelit;
- e) vendos për përdorimin e pasurisë së AMSHC-së;
- ë) zgjedh e shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e tij;
- f) emëron e shkarkon nga detyra drejtorin ekzekutiv;
- g) raporton në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e AMSHC-së;
- gj) kryen detyra të tjera, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me statutin e AMSHC-së.

## Neni 10

Vendimmarrja e bordit mbikëqyrës

1. Datat e mbledhjeve të bordit mbikëqyrës u njoftohen anëtarëve nga kryetari, të paktën 10 ditë para mbledhjes.

2. Mbledhja mbahet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të bordit mbikëqyrës. Vendimet e bordit mbikëqyrës merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenet 11 pika 1 e 12 pika 4 të këtij ligji, si dhe në vendimet për miratimin ose ndryshimin e statutit të AMSHC-së dhe për mënyrën e përdorimit të pasurisë së paluajtshme të agjencisë, të cilat merren me shumicën e thjeshtë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të bordit mbikëqyrës.

3. Mbledhjet e bordit mbikëqyrës, si rregull, janë të hapura për publikun. Vendi, data, ora dhe rendi i ditës i mbledhjeve njoftohen, paraprakisht, sipas pikës 4 të këtij neni.

4. Vendimet dhe njoftimet e bordit mbikëqyrës botohen në këndin e botimeve, në selinë e AMSHC-së, ose shpallen me çdo mjet tjetër, të përshtatshëm, në përputhje me përcaktimet e statutit ose të akteve të AMSHC-së.

5. Për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këtë ligj, funksionimi e vendimmarrja e bordit mbikëqyrës kryhen sipas ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

## Neni 11

### Kryetari i bordit mbikëqyrës

1. Kryetari e zëvendëskryetari i bordit mbikëqyrës zgjidhen e shkarkohen nga detyra me shumicën e thjeshtë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të bordit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet nga të paktën një e treta e anëtarëve.

2. Kryetari i bordit mbikëqyrës kryen këto detyra:

a) thërret mbledhjet e bordit, propozon rendin e ditës dhe drejton mbledhjet, sipas rregullave e procedurave, të përcaktuara në statutin e AMSHC-së;

b) përfaqëson bordin në marrëdhëniet me palë të treta;

c) mbikëqyr zbatimin e vendimeve të bordit;

ç) kryen çdo detyrë tjetër, të përcaktuar në statutin e AMSHC-së ose të ngarkuar nga bordi.

3. Në mungesë e në pamundësi të kryetarit, detyrat i kryen zëvendëskryetari i bordit mbikëqyrës.

4. Thirrja e mbledhjeve të bordit mbikëqyrës, rendi i ditës i mbledhjeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve të këtij bordi, sipas shkronjës “c” të pikës 2 të këtij neni, bëhen edhe nga të paktën një e treta e anëtarëve të bordit mbikëqyrës.

## Neni 12

### Drejtori ekzekutiv i AMSHC-së

1. Drejtori ekzekutiv kryen këto detyra:

a) përfaqëson AMSHC-në në marrëdhëniet me palë të treta;

b) administron, mbikëqyr e drejton veprimtarinë e AMSHC-së dhe të administratës së saj, përfshirë punësimin e administrimit e personelit, në përputhje me ligjin, statutin e agjencisë dhe vendimet e bordit mbikëqyrës;

c) i bën propozime e sugjerime bordit mbikëqyrës sa herë që i kërkohet ose, kryesisht, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së AMSHC-së;

ç) siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë, vendas ose të huaj, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së AMSHC-së;

d) ushtron çdo detyrë tjetër, që nuk i është dhënë bordit mbikëqyrës të AMSHC-së, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të legjislacionit në fuqi dhe statutit të agjencisë.

2. Anëtarët e bordit mbikëqyrës ose debitorë të AMSHC-së dhe të afërmit e tyre nuk mund të emërohen në detyrën e drejtorit ekzekutiv të agjencisë.

3. Drejtori ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e bordit mbikëqyrës pa të drejtë vote dhe ka të drejtë të propozojë çështje për t'u përfshirë në rendin e ditës të mbledhjeve të bordit.

4. Drejtori ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet me shumicën e thjeshtë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të bordit mbikëqyrës.

## Neni 13

### Kohëzgjatja e mandatit të organeve drejtuese të AMSHC-së

1. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të bordit mbikëqyrës është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Mandati i anëtarit të bordit mbikëqyrës mbaron përpara afatit në rastet kur:



a) jep dorëheqjen;

b) krijohen kushte të papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit, sipas nenit 14 të këtij ligji dhe vërtetohen shkeljet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;

c) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate;

ç) nuk merr pjesë në të paktën gjysmën e mbledhjeve të bordit, të organizuara gjatë një viti;

d) vdes;

dh) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Këshilli i Ministrave shkarkon anëtarin e bordit mbikëqyrës nga detyra, kur vëren shkelje të ligjit dhe të akteve të përgjithshme të AMSHC-së, kur ai ka interesa profesionale e financiare, që janë në konflikt me interesat e agjencisë, ose kur sjellja e qëndrimi i tij cenojnë autoritetin e AMSHC-së.

3. Bordi mbikëqyrës shkarkon nga detyra drejtorin ekzekutiv, kur vëren njërën nga shkeljet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Emërimi i anëtarit të ri të bordit mbikëqyrës ose i drejtorit ekzekutiv bëhet jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit.

## Neni 14

### Parandalimi i konfliktit të interesave

Anëtari i bordit mbikëqyrës ose i çdo organi tjetër të AMSHC-së nuk mund të votojë ose të marrë pjesë në vendimmarrje, kur ai, bashkëshorti ose bashkëshortja, i biri ose e bija, i afërmi, në vijë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me lidhje gjaku ose krushqie, deri në shkallë të dytë, ka interes financiar ose, në çështjet që lidhen me një person juridik, kur ai është anëtar, merr pjesë në administrimin e tij ose ka interes financiar në të, sipas ligjit.

## Neni 15

### Administrata e AMSHC-së

1. Struktura e administratës së AMSHC-së përcaktohet në statut.
2. Numri i punonjësve të AMSHC-së miratohet nga Këshilli i Ministrave, si zë më vete, në përputhje me ligjin për buxhetin vjetor të shtetit.
3. Nivelet e pagave dhe të shpërblimit të punonjësve të AMSHC-së, si dhe të kryetarit e anëtarëve të bordit mbikëqyrës miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AMSHC-së rregullohen sipas Kodit të Punës.
4. Fondi i pagave dhe ai i shpenzimeve të administratës së AMSHC-së miratohen, si zëra më vete, në ligjin për buxhetin vjetor të shtetit, krahas fondit për mbështetje të shoqërisë civile.
5. AMSHC-ja bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe personat juridikë, vendas ose të huaj, në përputhje me përcaktimet e statutit të saj.

## KREU V

### BURIMET E FINANCIMIT TË AMSHC-SË

#### Neni 16

#### Burimet e financimit

1. Burimet e financimit të AMSHC-së janë:
  - a) Buxheti i Shtetit;
  - b) të ardhurat që krijon ajo vetë;
  - c) dhurimet e ligjshme;
  - ç) të ardhura të tjera, të përcaktuara me ligj.
2. Buxheti i AMSHC-së parashikohet si zë më vete në buxhetin vjetor të shtetit dhe nuk mund të jetë më i vogël se në vitin pararendës.
3. AMSHC-ja siguron e pranon të ardhura e dhurime në vlerë, mallra ose shërbime dhe zbaton rregullat e marrëveshjes së nënshkruar me dhuruesin, në përputhje me misionin e saj dhe ligjet në fuqi.

4. AMSHC-ja realizon të ardhura sipas ligjit, nëpërmjet administrimit të pasurive të saj dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera të ligjshme.

Neni 17

Llogaritë bankare

1. AMSHC-ja mban llogari në sistemin e thesarit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Fondet e përfituara në monedhë të huaj depozitohen në llogari të veçanta bankare dhe administrohen sipas rregullave të sistemit të thesarit.

KREU VI

PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES E TË VENDIMMARRJES

Neni 18

Përgjegjësitë e organeve të AMSHC-së për shpërndarjen e fondeve

1. Fondi shpërndahet sipas përparësive të përcaktuara nga bordi mbikëqyrës.
2. Drejtori ekzekutiv i AMSHC-së:
  - a) siguron hartimin dhe zhvillimin e kushteve të granteve, në përputhje me specifikat e fushave;
  - b) shpall publikisht grantin dhe kriteret e konkurrimit e të përzgjedhjes së kandidatëve përfitues;
  - c) krijon komisionin e vlerësimit të projektpropozimeve, prej jo më pak se me 3 veta për çdo procedurë konkurrimi, në përbërje të të cilit marrin pjesë, me cilësinë e të ftuarit, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, sipas parimeve e rregullave të përcaktuara nga bordi mbikëqyrës;
  - ç) përcakton afatet dhe personat përgjegjës për negociimin e kushteve ose të ndryshimeve të nevojshme në projektpropozim, sipas kushteve të përcaktuara nga komisioni i vlerësimit;

d) njofton kandidatët pjesëmarrës në një procedurë të caktuar;

dh) lidh kontratën me fituesin.

3. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

a) hap, shqyrton dhe vlerëson kriteret e kualifikimit të projektpropozimeve të marra, në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara në dokumentet e konkurrimit;

b) shpall rezultatet e konkurrimit dhe vë në dijeni kandidatët pjesëmarrës për projektet jofituese, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

4. Në kontratë përcaktohen, të paktën, mënyra e transferimit të fondit, dokumentacioni dhe mënyra e raportimit financiar dhe të performancës, llojet e shpenzimeve, të njohura e të pranueshme, format e kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve dhe produktit/rezultateve të projektpropozimit të financiar, si dhe kushtet apo përgjegjësitë e tjera të ndërsjella.

5. Organi përgjegjës i autoriteteve të tjera financuese, në zbatim të pikave 2 e 3 të këtij neni, është titullari i këtij autoriteti.

Neni 19

Procedura bazë

1. Autoritetet financuese, në kuptim të këtij ligji, shpërndajnë fonde për mbështetje të shoqërisë civile, në bazë të konkurrimit të hapur e të përzgjedhjes publike të projektpropozimeve, në përputhje me parimet dhe procedurën e përcaktuar në këtë ligj.

2. Projektpropozimet vlerësohen në bazë të përputhshmërisë së tyre me qëllimet e programit, për të cilin janë propozuar, aftësisë së kandidatit dhe efektshmërisë së veprimtarive, për sa u përket rezultateve e kostove. Kriteret e hollësishme për vlerësimin për çdo grant shpallen publikisht. Këto kritere nuk mund të ndryshohen gjatë të gjithë procedurës përkatëse.

3. Procedura e përzgjedhjes së projektpropozimit përfshin fazat e mëposhtme:

a) botimin e planit vjetor të veprimit;

b) njoftimin paraprak e botimin e çdo procedure konkurrimi për një grant të caktuar dhe vënien në dispozicion të dokumenteve përkatëse të konkurrimit;

c) ndryshimet dhe sqarimet e bëra gjatë procedurës;

ç) dorëzimin e projektpropozimit dhe regjistrimin e kandidatëve pjesëmarrës nga autoriteti financiar;

d) shqyrtimin e pranueshmërisë së plotësisimit të aftësive teknike e financiare e të regjistrimit dhe vlerësimin e projektpropozimit;

dh) njoftimin e rezultateve të konkurrimit, përfshirë kushtet për përshtatje ose ndryshime;

e) në rast refuzimi të të gjithë kandidatëve, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

ë) negociimin e mundshëm për ndryshimet e përcaktuara, si kusht për miratimin e projektpropozimit fitues;

f) negociimin dhe nënshkrimin e kontratës;

g) botimin e informacionit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. Bordi mbikëqyrës, me propozimin e drejtorit ekzekutiv, miraton kontratën tip, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullat procedurale, të zbatueshme për fondet për mbështetje të shoqërisë civile, të cilat shpërndahen sipas këtij ligji.

Neni 20

Projektet

1. Projektet përmbajnë të dhëna për qëllimin, objektivat specifike, veprimtaritë, buxhetin, rezultatet e synuara. Vlerësimi i tyre parashtrohet sipas treguesve të qartë e përcaktimeve të justifikuar.

2. Projektet, sipas natyrës së tyre, përgatiten për një periudhë kohe të nevojshme për realizimin, sipas përcaktimeve të këtij ligji, e cila mund të kalojë kufirin e një viti financiar.

3. Në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar, fondi i grantit për veprimtaritë e projektit transferohet mbi bazë vjetore, në përputhje me veprimtaritë, që kryhen në vitin përkatës.

Neni 21

Dokumentet e konkurrimit

1. Autoriteti financues përgatit dokumentet e konkurrimit, në të cilat përfshihen të paktën:

a) të dhëna të përgjithshme për këtë autoritet;

b) kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm për të provuar këto kriteret;

c) kushtet e grantit;

ç) udhëzime për afatet dhe formalitetet që duhet të respektohen;

d) të dhëna për kriteret e përdorura për përzgjedhjen e kandidatëve.

2. Kushtet e grantit përmbajnë karakteristikat e projektit, fushën e veprimit, objektivat specifike, veprimtaritë e nevojshme që duhen kryer dhe kriteret e vlerësimit të rezultateve.

3. Granti nuk do të përdoret, në asnjë rast, për financimin e kostove operative të tjera të kandidatit përfitues, jashtë projektit të përzgjedhur.

Neni 22

Vënia në dijeni e publikut dhe format e komunikimit

1. Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të shpërndarjes së fondeve, sipas këtij ligji, procedurat e përzgjedhjes, kontratat e nënshkruara ndërmjet autoritetit financues e kandidatit përfitues, si dhe raportimet për shpenzimin e fondeve të dhëna, sipas këtij ligji, janë informacion me interes publik, në përputhje me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare.

2. Të gjitha njoftimet për procedurat e konkurrimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, shpallen në faqen e internetit të autoritetit financues dhe në të paktën dy gazeta kombëtare ose vendore, sipas nivelit të autoritetit financues. Autoritetet financuese përdorin, sipas mundësive, çdo mjet tjetër për botimin e procedurave të konkurrimit.

3. Autoritetet financuese shpallen në faqen e tyre të internetit emrat e të gjithë përfituesve të projekteve, përmbledhjen e projekteve të financuara dhe shumat përkatëse të granteve. Autoritetet financuese, për projektet e financuara prej tyre, sipas këtij ligji, i dërgojnë informacionin përkatës AMSHC-së, e cila e shpall atë në faqen e saj të internetit.

Neni 23

Afatet kohore

1. Autoriteti financues duhet të përcaktojë dhe të përfshijë në njoftimin për pjesëmarrje në një procedurë konkurrimi afatin e dorëzimit të projektpropozimeve. Ky afat nuk mund të jetë më i vogël se 30 ditë kalendarike nga data e botimit të njoftimit.
2. Autoriteti financues ka të drejtë ta zgjasë afatin e paraqitjes së projektpropozimit, me kusht që afati i ri të jetë botuar publikisht, të paktën 6 ditë para mbarimit të afatit të mëparshëm.
3. Afati për vlerësimin e projektpropozimeve dhe shpalljen e rezultateve është jo më shumë se 30 ditë nga afati i përcaktuar në dokumentet e konkurrimit, për dorëzimin e projektpropozimeve. Kandidatët njoftohen brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të vlerësimit të rezultateve të konkurrimit. Autoriteti financues dhe kandidati përfitues nënshkruajnë kontratën brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të rezultateve të konkurrimit.

#### Neni 24

##### Sqarimet

1. Çdo person juridik ose fizik ka të drejtë të kërkojë e të marrë sqarime të mëtejshme nga autoriteti financues.
2. Autoriteti financues ka detyrimin të japë përgjigje për çdo kërkesë sqarimi, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit të paraqitjes së projektpropozimeve. Çdo përgjigje shpallet në faqen e internetit dhe është e aksesueshme për të gjithë kandidatët.
3. Autoriteti financues duhet të kthejë përgjigje për çdo kërkesë sqarimi, të paktën 3 ditë para afatit të paraqitjes së projektpropozimeve.
4. Autoriteti financues ka të drejtë, me nismën e tij, të japë informacion sqarues shtesë për dokumentet e konkurrimit, të cilin duhet t'ia komunikojë të gjithë kandidatëve, sipas afateve të përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni.

#### Neni 25

##### Zbatimi i kontratës

1. Çdo projekt i financuar monitorohet nga autoriteti financues për zbatimin e veprimtarive të deklaruara.
2. Autoriteti financues nuk i paguan, përpara vlerësimit të raportit përfundimtar të veprimtarisë dhe bilancit financiar, koston e fundit kandidatit përfitues, i cili është i detyruar t'ia dorëzojë autoritetit jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i veprimtarisë.
3. Vlerësimi kryhet jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së raporteve të përmendura në pikën 2 të këtij neni.
4. Autoriteti financues mund të rezervojë të drejtën të kërkojë informacion shtesë nga kandidati përfitues, si gjatë zbatimit të kontratës, ashtu edhe pas vlerësimit të raporteve të veprimtarisë, me qëllim që të plotësojë dokumentacionin, por jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

Neni 26

Rishikimi, hetimi administrativ dhe ankimi

Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative janë të zbatueshme për rishikimin, hetimin administrativ dhe ankimin.

## KREU VII

### AUDITIMI E RAPORTIMI FINANCIAR I VEPRIMTARISË SË AMSHC-SË

Neni 27

Auditimi

Veprimtaria financiare e AMSHC-së auditohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28



## Raportimi financiar

1. Viti financiar i AMSHC-së është i njëjtë me vitin kalendarik.
2. Me mbylljen e vitit financiar, drejtori ekzekutiv i paraqet auditit të AMSHC-së bilancin vjetor të të ardhurave e të shpenzimeve dhe gjendjen e pasurive të kësaj agjencie për vitin e fundit financiar. Drejtori ekzekutiv, brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar, i paraqet bordit mbikëqyrës raportimin e mësipërm dhe raportin e auditit.

## KREU VIII

### DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

#### Neni 29

Emërimi i anëtarëve të bordit të parë mbikëqyrës

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në mbështetje të pikave 3 e 5 të nenit 8 të këtij ligji, të emërojë anëtarët e bordit të parë mbikëqyrës të AMSHC-së brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 30

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të pikave 2 e 3 të nenit 15 të këtij ligji.

#### Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6103, datë 19.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**